

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6809
E enjte, 26 janar 2023
çmimi 0.40 €

OVLUÇK-ja i bën kërkesë policisë: Na mbronni objektin



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHBA-JA, THIRRJE KOSOVËS TA PRANOJË PROPOZIMIN EVROPIAN
PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE ME SERBINË

CHOLLET INKURAJON KURTIN TA PRANOJË PROPOZIMIN E BE-së



Këshilltari i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka bërë me dije se e ka inkurajuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, që ta

pranojë propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Në bisedën përmes telefonit me Kurtin, zyrtari amerikan ka theksuar se kanë

folur edhe për rëndësinë e karakterit shumetnik të Kosovës dhe ecjen përpara me diskutime për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe

AKTUALE



GJERMANIA JEP DRITËN
JESHILE PËR DËRGIMIN E
TANKEVE NË UKRAINË

NË STRASBURG KËRKOHEM
MBËSHTETJE PËR ANËTARËSIMIN
E KOSOVËS NË KËSHILLIN
E EVROPËS

"TEHNO BURIMI" DO TË MARRË
PËRSIPËR NDËRTIMIN E DY URAVE
MBI LUMIN LUSHTA

EKONOMI



ABDIXHIKU TAKON QYTETARËT NË
KRYEQYTET: KOSTOJA E JETESËS
ËSHTË BËRË E PAPËRBALLUESHME

NDAHEN GJYSMË
MILIONI EURO PËR
PROJEKTIN 'VIZITA NË
SHTËPI PËR GRATË
SHTATZËNA DHE FËMIJËT'
NË PRISHTINË



QEVERIA NDAN 50 EURO
SHTESË PËR PUNËTORËT
E SEKTORIT PUBLIK PËR
MUJIN JANAR

F. 8

RREZIKU NGA KAFSHËT E
NGORDHURA GJATË PËRMBYTJEVE

F. 8

SPORT



FC PRISHTINA NUK DO TA VOTOJË
DRAFT-STATUTIN E FFK-së

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania jep dritën jeshile për dërgimin e tankeve në Ukrainë

BERLIN, 25 JANAR - Qeveria gjermane ka konfirmuar se do t'i sigurojë Ukrainës tanke luftarake Leopard 2 dhe do t'i miratojë kërkesat e vendeve të tjera për të bërë të njëjtën gjë. Kancelari Olaf Scholz tha të mërkurën se Gjermania "po vepron në koordinim të ngushtë" me aleatët e saj. Scholz tha se vendimi për të dërguar tanke ishte "parim i drejtë" pasi po vazhdon pushtimi rus i Ukrainës. Ai shtoi se aleatët perëndimorë do të vazhdojnë ta mbështesin Ukrainën. "Ne gjithmonë duhet të jemi të qartë për gjithçka që bëjmë dhe çfarë është e nevojshme dhe e mundur për ta mbështetur Ukrainën. Por, në të njëjtën kohë, ne po

parandalojmë përshkallëzimin e luftës në një luftë midis Rusisë dhe NATO-s", tha Scholz para Parlamentit gjerman. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky falënderoi Scholzin për "vendimin e rëndësishëm dhe në kohë të duhur" të Gjermanisë teksa shtoi se ka edhe "drita të gjelbra për partnerët që të na furnizojnë me armë të ngjashme". Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, mirëpriti "fuqishëm" vendimin gjerman për tanket, duke thënë se kjo do ta ndihmojë Kievin t'i mposhtë forcat pushtuese ruse. "Në një koment kritik të luftës së Rusisë, tanket do ta ndihmojnë Ukrainën ta mbrojnë veten, të fitojë si një shtet i pavarur",

shkroi ai në "Twitter". Megjithatë, Rusia është shprehur e zemëruar me vendimin. Ambasadori rus në Gjermani, Sergei Nechayev, tha se ky vendim ishte "ekstrem i rrezikshëm", duke akuzuar Berlinin se po pritet ta "përshkallëzojë" konfliktin. "Ky është një vendim shumë i rrezikshëm që e çon konfliktin në një nivel të ri", tha ai. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se vendimet e Perëndimit, përfshirë edhe dërgimin e tankeve, po krijojnë një situatë "shumë, shumë të tensionuar" të sigurisë në Evropë dhe për botën në përgjithësi. Ndërkaq, zëdhënësi i qeverisë gjermane, Steffen Hebestreit, tha

më 25 janar se qëllimi është që të krijohen shpejt dy batalione me tanke Leopard 2 për Ukrainën, duke shtuar se Gjermania në hapin e parë do të sigurojë 14 tanke nga rezervat e veta ushtarake. Trajnimi i trupave ukrainase për përdorimin e këtyre tankeve do të fillojë së shpejti dhe Gjermania, gjithashtu, do të sigurojë logjistikë dhe municione, tha Hebestreit. Vendimi i shumëpritur pasoi njoftimin e zyrtarëve amerikanë se ishte arritur një marrëveshje paraprake që Shtetet e Bashkuara të dërgonin tanke M1 Abrams për të ndihmuar Kievin t'i zmbrapsë forcat ruse të vendosura në lindje të vendit. Scholz kishte këmbëngulur se

çdo lëvizje për t'i siguruar Ukrainës tanke të fuqishme Leopard 2 do të duhej të koordinohet ngushtë me aleatët e Gjermanisë, kryesisht Shtetet e Bashkuara. Anëtarët e qeverisë të koalicionit trepartiak të Scholzit e mirëpritën lajmin përpara njoftimit zyrtar. Ukraina ka muaj që kërkon tanke luftarake, për t'i luftuar forcat ruse që e kanë nisur luftën në këtë shtet. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky beson se rreth 300 tanke Leopard do të ndihmonin në mposhtjen e Rusisë. Polonia, Spanja, Finlanda, Holanda dhe Norvegjia dhe disa shtete të tjera pritet të dërgojnë tanket e tyre Leopard në Ukrainë.



Disa prokurorë të Ukrainës shkarkohen nga detyra

Kiev, 25 janar - Prokurorët në pesë rajone të Ukrainës janë shkarkuar nga detyra, mes një skandali korrupsioni të profilit të lartë, që ka çuar në disa dorëheqje dhe shkarkime të zyrtarëve të lartë në të gjithë vendin. Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm tha më 25 janar se prokurorët e rajoneve Zaporizhzhya, Kirovohrad, Poltava, Sumy dhe Chernihiv ishin liruar nga detyrat e tyre. Skandali i korrupsionit shpërtheu më 22 janar, kur Ministria e Mbrojtjes u akuzua nga një gazetë për mbipagimin e furnizuesve për ushqimin e ushtarëve ukrainas. Furnizuesi ka thënë se faji ishte i tyre nga një

gabim teknik dhe se nuk ishin dhënë para shtesë. Ministria tha se akuzat ishin të pabaza. Në të njëjtën ditë, zëvendësministri i Infrastrukturës i Ukrainës u arrestua me dyshimin se kishte marrë ryshfet prej 400 mijë dollarësh për importimin e gjeneratorëve në shtator, një akuzë të cilën ai e mohon. Nënkryetari i administratës presidenciale, Kyrylo Tymoshenko, njoftoi më 24 janar se i kishte paraqitur dorëheqjen Zelenskit. Pak kohë pas njoftimit të Tymoshenkos, zëvendësministri i Mbrojtjes, Vyacheslav Shapovalov, që ishte përgjegjës



për furnizimin e ushtrisë me ushqim dhe pajisje, gjithashtu dha dorëheqje, duke përmendur "akuzat e medieve" për

korupsion. Dy zëvendësministria, Vyacheslav Nehoda dhe Ivan Lukerya nga Ministria e Komuniteteve dhe Zhvillimit të Territoreve të Ukrainës, dhanë gjithashtu dorëheqje më 24 janar. Po të njëjtën ditë Oleksiy Symonenko, zëvendësprokurori i përgjithshëm i Ukrainës, u shkarkua. Largimet e zyrtarëve pasuan njoftimin e presidentit Volodymyr Zelensky më 23 janar, se do të bënte ndryshime në udhëheqje në nivele të larta dhe të ulëta. Zelensky u zotua për çrrënjosje të korrupsionit nga administrata e tij.

Ndërkombëtarët i bëjnë thirrje Shkupit ta ndryshojë Kushtetutën

Shkup, 25 janar - Përfaqësuesit ndërkombëtarë në Maqedoninë e Veriut kanë shuar thirrjet drejtuar partive politike për nevojën e miratimit të ndryshimeve kushtetuese si kusht për vazhdimin e bisedimeve të anëtarësimit evropian.

Ndryshimi i Kushtetutës duhet të bëhet për përfshirjen e pakicës bullgare në të, si popull shtetformues, në të kundërtën Sofja sërisht mund ta bllokojë vazhdimin e bisedimeve mes BE-së dhe Maqedonisë së Veriut.

Ky obligim për autoritetet maqedonase parashihet me marrëveshjen mes dy vendeve që bazohet në atë që njihet si "propozimi francez" për zgjidhjen e kontesteve për gjuhën, identitetin dhe të kaluarën historike mes dy vendeve.

Ambasadorja e ShBA-së në Shkup, Angela Aggeler, deklaroi në Gostivar se në të gjitha takimet me liderët politikë thekson rëndësinë që kanë për vendin ndryshimet kushtetuese. "Unë u them të gjithëve që takoj se kjo është e rëndësishme dhe nuk është vetëm e rëndësishme ta bëjmë këtë, por është e rëndësishme që këtë shtet ta vendosin në vendin e parë dhe jo agjendat personale përpara



agjendave më të mira të këtij vendi... Kjo është ajo që bëj çdo ditë dhe vazhdoj ta bëjë këtë. Shpresoj që të zgjedhurit tuaj të bëjnë atë që unë e konsideroj më të mirën për vendin", tha ambasadorja Aggeler.

Një gjë të tillë ajo e kishte theksuar edhe në takimin e fundit me kryetarin e Aleancës Shqiptare në opozitë, Arben Taravari, që po shqyrton mundësinë e hyrjes në qeveri për mbështetjen e ndryshimeve kushtetuese.

Ndërkohë, nga misioni i BE-së në Shkup, thanë se ndryshimet kushtetuese burojnë nga marrëveshja, për të cilën shteti

është angazhuar në marrëdhëniet bilaterale me Bullgarinë dhe në rast se nuk miratohen këto ndryshime, mund të bllokohet edhe procesi i integritimit evropian. "Maqedonia e Veriut tashmë ka një histori të mirë të marrëdhënieve ndëretnike dhe mendoj se do të marrë një vendim që do t'i forcojë edhe më shumë, pa prekur identitetin e këtij vendi sepse identiteti nuk humbet në rrugën drejt BE-së. Megjithatë, për shkak se kjo është pjesë e marrëveshjes së realizuar që rezultoi me hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian, nëse ky ndryshim nuk ndodh, procesi i

negociatave do të ndalojë, dhe çfarë do të ndodhë më pas, nuk mund të themi", thanë nga zyra e BE-së në Shkup.

Procedura për ndryshimet kushtetuese, sipas qeverisë maqedonase, do të nisë së shpejti, fillimisht me debate ku do të përfshihen ekspertët dhe faktorët e tjerë të shoqërisë. "Rëndësia politike është shumë më e madhe se ajo e ndryshimit të një pjese të Kushtetutës, të preambulës së saj për përfshirjen e bullgarëve në të. Vendimi për ndryshimin e Kushtetutës nënkupton vendimin për dhënien e dritës jeshile vazhdimit të bisedimeve për

anëtarësim evropian", deklaroi ministri i Drejtësisë, Bojan Mariçiq. Ndryshimet miratohen në Kuvend me dy të tretat, apo me 80 nga 120 votat e deputetëve. Por, shumica parlamentare aktualisht ka 75 vota, sikur pjesë e qeverisë të bëhej edhe Aleanca për Shqiptarët. Domethënë mungojnë edhe pesë vota të cilat kërkohen nga radhët e opozitës maqedonase.

Por, kryetari i VMRO DPMNE-së opozitare, Hristijan Mickoski, tha se askush nuk ka marrë mandat në zgjedhje për ndryshimin e Kushtetutës. "Qëndrimi është se ky parlament nuk ka mandat për ndryshimin e Kushtetutës, sepse opozita nuk ka marrë pjesë në hartimin e asaj marrëveshjeje, as nuk është pajtuar me atë marrëveshje dhe as nuk ka shkuar para qytetarëve për të premtuar se do të ketë ndryshime kushtetuese", tha Mickoski. Sipas tij, në zgjedhjet e fundit asnjë parti politike nuk e ka paraqitur si pjesë të programit të saj ndryshimin e Kushtetutës. Për këtë arsye Mickoski konsideron se zgjedhjet e parakohshme janë e vetmja mënyrë që qytetarët të thonë se çfarë mendojnë dhe në cilin drejtim duhet të lëvizë Maqedonia e Veriut në periudhën e ardhshme. /Rel

Qeveria ndan 50 euro shtesë për punëtorët e sektorit publik për muajin janar

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 JANAR - Në mbledhjen e 121-të të kabinetit qeveritar është miratuar Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2023 i cili parashihet që gjatë këtij viti qeveria do të përgatisë dhe procedojë 100 projektligje në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, është miratuar Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin për

Lirinë Fetare me të cilin, ndër të tjera, synohet të rregullohet statusi juridik i bashkësive fetare në Kosovë.

Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se për zbatimin e masës 4.1 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike "miratuar ndarjen e shtesës prej 60 eurosh për muajin janar për stafin shëndetësor". Gjithashtu kabineti qeveritar ka miratuar ndarjen e shtesës prej 50 eurosh për muajin janar për sektorin publik. "Me qëllim të ngritjes së

kapaciteteve energjetike, për organizimin e ankandit për panelet solare nga Ministria e Ekonomisë, miratuar bartjen e së drejtës së shfrytëzuesit në parcelat kadastrale në komunën e Rahovecit. Për ndërtimin e Parkut me Panele Solare për prodhim të energjisë elektrike me kapacitet prej 100 MW, miratuar kërkesën për shpronësim të pronave në Kryshevc të Obiliqit dhe në Fushë-Kosovë. Miratuar vendimin për masat emergjente

në furnizim me energji. Me synim përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e efikasitetit në prodhimtarinë primare bujqësore, miratuar Projektligjin për Verërat", ka treguar Kurti.

Ai ka bërë me dije se në këtë mbledhje u miratua edhe Projektligji për Shëndet Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar. "Emëruam anëtarët e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve. Për ta riafirmuar pavarësinë

institucionale dhe juridike të Akademisë së Drejtësisë, miratuar koncept-dokumentin për Akademinë e Drejtësisë. Emëruam kryetarin e Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Miratuar vendimin për shpronësim për projekte infrastrukturore në komunën e Podujevës. Miratuar nismat për marrëveshje ndërkombëtare me Qeverinë e Konfederatës Zvicerane si dhe Mbretërinë e Bashkuar", ka deklaruar kryeministri Kurti.



SHBA-JA, THIRRJE KOSOVËS TA PRANOJË PROPOZIMIN EVROPIAN PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE ME SERBINË

Chollet inkurajon Kurtin ta pranojë propozimin e BE-së

Këshilltari i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka bërë me dije se e ka inkurajuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, që ta pranojë propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Në bisedën përmes telefonit me Kurtin, zyrtari amerikan ka theksuar se kanë folur edhe për rëndësinë e karakterit shumetnik të Kosovës dhe ecjen përpara me diskutimet për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 JANAR - Këshilltari i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka thënë se e ka inkurajuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, që ta pranojë propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Përmes një postimi në "Twitter", ai ka bërë me dije se ka biseduar me Kurtin për këtë çështje të martën. "Një temë kyçe ka qenë partneriteti ynë dhe synimi i përbashkët për avancimin e integritimit evropian dhe euroatlantik të Kosovës", ka shkruar Chollet.

Ai ka theksuar se me Kurtin ka biseduar edhe për çuarjen përpara të diskutimeve për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Ne diskutuam, gjithashtu,

për rëndësinë e karakterit multi-etnik të Kosovës dhe ecjen përpara me diskutime për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në kontekstin e dialogut me Serbinë dhe nevojën që serbët e Kosovës të kthehen në institucione", ka shkruar Chollet. Ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, tha se "pajtohet plotësisht" me deklaratat e këshilltarit të Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, sa i përket shtyrjes përpara të diskutimeve për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Jam plotësisht dakord: është shumë e rëndësishme ta çojmë përpara diskutimin për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Është mirë të dëgjosh se ministri i Kosovës, Nenad Rashiç, ka konfirmuar pjesëmarrjen e tij në diskutimin e

planifikuar për këtë çështje më 31 janar në Ambasadën Amerikane në Prishtinë", tha ambasadori gjerman.

Kjo deklaratë vjen në kohën kur ministri për Komunitete dhe Këthim në Qeverinë e Kosovës, Nenad Rashiç, konfirmoi se ka marrë ftesë nga Shtetet e Bashkuara për të marrë pjesë në një diskutim të organizuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë më 31 janar për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Marrëveshja për krijimin e këtij asociacioni është arritur qysh në vitin 2013 në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi i cili ndërmjetësohet nga BE-ja, por ajo nuk është zbatuar kurrë.

Dy vjet më vonë, përkatësisht në vitin 2015, palët janë pajtuar për parimet e Asociacionit, por Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar më pas se disa prej tyre nuk janë në përputhje me ligjet e Kosovës, megjithëse ka thënë se ato të mund të harmonizohen. Zyrtarët në Kosovë thonë se nuk mund të krijohen asociacione njëjetnike, ndërsa ata në Serbi këmbëngulin në formimin e Asociacionit të dakorduar.

I dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, pati deklaruar se nëse Qeveria e Kosovës nuk gjen mënyrë për formimin e Asociacionit, ShBA-ja do të kërkojë "partnerë alternativë". Ai ka thënë se këta partnerë mund të jenë nga shoqëria civile, grupet shumetnike apo institutet, përkatësisht subjekte që mund të ofrojnë ide, mbi bazën e të cilave mund të krijohet Asociacioni pa e shkelur Kushtetutën e Kosovës. Propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi u është dorëzuar dy vendeve në fund të verës, por përmbajtja e tij nuk është bërë publike.

Në bazë të një versioni që ka dalë në publik në medie, ai nuk përfshin njohjen reciproke midis Kosovës dhe Serbisë, por përkushtimin e të dyja palëve që të mos e pengojnë njëra-tjetrën në procesin e integritimeve.

Në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë" javën e kaluar, Chollet ka thënë se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të kërkojë "zgjedhje të vështira" dhe "guxim politik". Nga një takim që ka zhvilluar një delegacion evropiano-amerikan me Kurtin, më 20 janar në Prishtinë,

është thënë se ata kanë pritur më shumë mirëkuptim në lidhje me propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovës dhe Serbisë.

Kurti ka thënë pas atij takimi se propozimi është "bazë e mirë për bisedime të mëtejshme", por nuk ka specifikuar më shumë.

Në Serbi presidenti Aleksandër Vuçiq ka thënë se është i gatshëm të punojë në planin për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën.

Serwer: Në planin franko-gjerman nuk përmendet njohja nga Serbia

Analisti Daniel Serwer ka deklaruar se versioni i fundit i planit franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, në të cilën, siç thotë ai, përfshihen më shumë detaje rreth rregullimit të jetës së komunitetit serb në Kosovë, mirëpo nuk përmendet njohja e Kosovës nga pesë shtetet e BE-së dhe as çështja e të drejtave të komunitetit shqiptar në Serbi. Serweri ka theksuar se versioni i fundit i këtij plani është një "hap kah drejtimin e duhur" nëse zbatohet plotësisht, por ka "shtesa të diskutueshme" dhe të meta.

Në Strasburg kërkohet mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës

Prishtinë, 25 janar - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe delegacioni i Kuvendit në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), ka mbajtur disa takime me drejtues të lartë të APKE-së, të grupeve politike e të komiteteve.

Në ditën e parë të vizitës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në Strasburg të Francës, Konjufca, i shoqëruar nga nënkryetarja e Kuvendit dhe kryesuese e delegacionit, Saranda Bogujevci, si dhe anëtarët e tjerë, deputetët Enis Kervan, Besnik Tahiri dhe Ariana Musliu Shoshi, u prit në një takim të veçantë nga presidenti i APKE-së, Tiny Kox dhe sekretarja e përgjithshme Despina Chatzivassiliou.

Konjufca ka zhvilluar takime të ndara edhe me kryesuesin e Komitetit për Çështje Politike dhe Demokraci, Zsolt Nemeth, kryesuesin e Grupit Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën, Iulian Bulai, me deputetin nga radhët e delegacionit gjerman në APKE, Knut Abraham, si dhe me George



Papandreu nga radhët e delegacionit grek.

Në këto takime u diskutua për aplikimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, rëndësinë dhe mbështetjen e nevojshme, për të siguruar që Kosova të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës,

progresin në respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe sundim të ligjit, gjë që dëshmohet nga raporte ndërkombëtare, si dhe tema të tjera me interes për thellimin e bashkëpunimit me Këshillin e Evropës.

Gjatë takimeve u kuptua rëndësia dhe domosdoshmëria e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës përderisa kryetari Konjufca kërkoi mbështetje në këtë proces. Vizita në Strasburg po zhvillohet në kuadër të punimeve të seancës

vjeshtore të APKE-së e cila po mbahet në datat 23-27 janar 2023. Konjufca ka zhvilluar edhe një sërë takimesh të tjera me kryesues të grupeve dhe delegacione të parlamenteve të ndryshme, pjesëmarrëse në Asamble.

Mbahen konsultimet politike në mes të Ministrisë së Jashtme të Kosovës dhe asaj të Belgjikës

BRUKSEL, 25 JANAR - Nën drejtimin e zëvendësministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti dhe drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë për Marrëdhënie Bilaterale, ambasadorit Jeroen Cooreman, të mërkurën në Bruksel u mbajtën konsultimet politike mes ministrive të Punëve të Jashtme të të dyja shteteve. Përgjatë konsultimeve u vlerësua ngritja e ndërveprimit ekonomik dhe tregtar mes ekonomive të të dyja vendeve dhe u shqyrtuan mundësitë për lehtësimin e mëtutjeshëm të këtyre zhvillimeve.

Në takim u diskutua edhe për reformat që po ndërmerren Qeveria e Kosovës dhe u shpreh gatishmëri për bashkëpunim dhe shkëmbim të përvojave të mira. Zëvendësministri Ahmeti ka falënderuar ambasadorin Cooreman për mbështetjen e Belgjikës për procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës dhe Bashkimin Evropian, duke theksuar rëndësinë që këto dy organizata kanë për mirëqenien e



qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Tema të tjera në këtë takim ishin edhe bashkëpunimi në fushën e

sigurisë dhe situata në rajonin e Ballkanit nën hijen e agresionit

ushtarak të Federatës Ruse mbi Ukrainën.

Profesori nga Universiteti John Hopkins në Uashington shtoi se në nenin 7 thuhet se të dyja palët janë të përkushtuara për arritjen e marrëveshjeve konkrete në përputhje me instrumentet përkatëse të Këshillit të Evropës dhe

duke përdorur përvojat ekzistuese evropiane "për të siguruar një nivel të duhur të vetëqeverisjes për komunitetin serb në Kosovë dhe mundësia e ofrimit të shërbimeve për Kosovën", siç u tha, në fusha të caktuara, duke përfshirë

mundësinë e ndihmës financiare nga Serbia dhe kanalet e drejtpërdrejta të komunikimit ndërmjet komunitetit serb dhe Qeverisë së Kosovës. Në pjesën e atij shkrimi të publikuar nga Serveri thuhet se

palët do ta zyrtarizojnë statusin e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë dhe do të sigurojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në përputhje me modelet ekzistuese evropiane. Ai deklaroi se një nga

mangësitë është se paragrafi i parë nuk e përmend Kushtetutën e Kosovës si bazë për "aranzhimet konkrete" të përmendura dhe se reciprociteti brenda Serbisë nuk kërkohet për komunitetin shqiptar.

“Tehno Burimi” do të marrë përsipër ndërtimin e dy urave mbi lumin Lushta

MITROVICË, 25 JANAR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur të mërkurën në takim afaristin mitrovicas Burim Fazliu, pronar i kompanisë “Tehno Burimi”.

Në këtë takim është biseduar lidhur me situatën aktuale të komunës së Mitrovicës pas

vërshimeve të shkaktuara nga reshjet e shiut, ku kanë lënë dëme të shumta jo vetëm në ekonomi familjare, biznese, bujqësi, por edhe në infrastrukturën publike.

Me këtë rast, kompania “Tehno Burimi”, me pronar Burim Fazliu, ka shprehur gatishmërinë

ta mbështesë komunën me ndërtimin e dy urave mbi lumin Lushta, të cilat janë dëmtuar nga vërshimet e fundit.

Kryetari Hamza ka falënderuar afaristin mitrovicas Fazliu për iniciativën e tij që t'i dalë në ndihmë komunës dhe qytetarëve të Mitrovicës.



Zbulohet murali në shkollën “Shaban Shala” dedikuar fëmijëve me aftësi të kufizuara

PODUJEVË, 25 JANAR - Në Ditën Botërore të Edukimit, organizata “Oaktiv” ka organizuar aktivitetet për fëmijët me aftësi të kufizuara, ku ka zbuluar muralin sensibilizues për fëmijët me aftësi të kufizuara, me moton “Ëndrrat e një fëmije me aftësi të kufizuara”.

Nënkryetarja e komunës së Podujevës, Marigona Lahu, u shpreh e lumtur që janë mbledhur bashkë për zbulimin e muralit “Ëndrrat e një të riu me aftësi të kufizuara”, ku tha se murali shërben që të reflektojmë secili nga ne për krijimin e kushteve dhe infrastrukturës për fëmijët me nevojë të veçanta dhe reflektim

mbi zhdukjen e paragjyqimeve. Aktiviteti u mbajt në kuadrin e projektit “Ec me këmbët e tyre”, mbështetur nga Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 - ReLOaD2, financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatuar nga Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (UNDP), ku si objektivi përgjithshëm i ReLOaD2 është t'i forcojë demokracinë pjesëmarrëse, ta përforcojë bashkëpunimin midis qeverisjes lokale dhe organizatave të shoqërisë civile dhe ta promovojë angazhimin civil dhe të rinisë në vendimmarrje dhe në zhvillimin e komunitetit.

Nënshkruhen kontratat me 79 përfituesit e serrave në Mitrovicë

MITROVICË, 25 JANAR - Komuna e Mitrovicës, në bashkëpunim me organizatën “Islamic Relief Kosova”, në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, kanë realizuar me sukses projektin për subvencionimin e fermerëve me serra, me të cilët sot kanë nënshkruar kontratat.

Në ceremoninë e nënshkrimit të këtyre kontratave morën pjesë kryetari i komunës, Bedri Hamza,

përfaqësuesja e organizatës “Islamic Relief Kosova”, Albulena Gashi, si dhe drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ferdi Kadriu.

Me rastin e nënshkrimit të kontratave, kryetari z. Hamza, pasi ka falënderuar për mbështetjen e dhënë për realizimin e këtij projekti “Islamic Relief Kosova”, uroi fermerët përfitues, duke u thënë atyre se këto serra do t'u ndihmojnë për kultivimin e prodhimeve

vendore, gjë që do të thotë se jo mbështetje është e mirëseardhur edhe për furnizimin e tregut me kultura bimore.

Marrëveshja e bashkëpunimit në mes të komunës së Mitrovicës dhe “Islamic Relief Kosova” përfshin shumën mbi 300 mijë euro përmes së cilës pritet të realizohen edhe projekte të tjera gjatë këtij viti, duke shpërndarë grante të ndryshme bujqësore për fermerët.



Nënshkruhet marrëveshja për zbatimin e masave të efijencës së energjisë në shkollën “Abaz Ajeti” në Gjilan

GJILAN, 25 JANAR - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka nënshkruar sot një marrëveshje për shërbime të energjisë me drejtorin e Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE), Ahmet Ismaili.

Marrëveshja e cila e kap vlerën 350 mijë euro, çon përpara realizimin

e projektit të zbatimit të masave të efijencës së energjisë në ShFMU “Abaz Ajeti”.

Kryetari Hyseni tha se kjo marrëveshje u nënshkrua me qëllim rritjen e efijencës përmes kursimit të energjisë dhe buxhetit, si dhe përmirësimit të standardeve të shkollës “Abaz

Ajeti”. “Ne do të vazhdojmë të angazhohemi drejt jetësimit të projekteve të sektorit të energjisë për Gjilanin edhe në shkollat e objektet e tjera komunale, si dhe çdo projekti me impakte pozitive në mirëqenien e qytetarëve tanë”, është shprehur kryetari i komunës, Alban Hyseni.

Në Deçan bëhet thirrje për bojkotim të produkteve të Serbisë

DEÇAN, 25 JANAR - Drejtori i Ekonomisë dhe Zhvillimit në Deçan, Isuf Demhasaj, së bashku me aktivistë të

Aleancës së të Rinjve të Kosovës (ARK) në Deçan, kanë vendosur stikera sensibilizues dhe kanë shpërndarë

fletushka që bëjnë thirrje për bojkotimin e produkteve serbe. “Bojkotimi i produkteve të këtij vendi kriminal rrit

kërkesën e produkteve vendore dhe fuqizon ekonomisht Republikën e Kosovës!”, ka thënë Demhasaj.



Ndahen gjysmë milioni euro për projektin “Vizita në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët” në Prishtinë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 JANAR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka marrë pjesë në fillimin e programit “Vizita në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët 0-3 vjeç, pjesë e të cilit projekt nga dita e mërkurë do të jetë edhe komuna e Prishtinës.

Programi i vizitave në shtëpi për kujdes ndaj nënës dhe fëmijës ka filluar në vitin 2013 dhe realizohet nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me UNICEF-in.

Gjatë këtij takimi ministri Vitia ka shpjeguar rëndësinë e këtij projekti për të cilin Qeveria e Kosovës për herë të parë vitin e

kaluar në kuadër të grantit specifik për shëndetësinë primare ka buxhetuar 3.4 milionë euro.

Nga ky grant komuna e Prishtinës do të përfitojë rreth gjysmë milioni euro për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. “Ministria e Shëndetësisë e udhëheq këtë program me mbështetje logjistike nga UNICEF-i. Jam i lumtur që nga sot pjesë e projektit ‘Vizita në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët’ 0-3 vjeç bëhet edhe komuna e Prishtinës e cila ofron një gamë të gjerë shërbimesh në kujdesin parësor për një numër të madh banorësh. Rëndësia e këtij projekti qëndron edhe në preventivën e sëmundjeve në moshë të

hershme”, ka thënë ministri Vitia, i cili i falënderoi përzemërsisht UNICEF-in dhe Qeverinë e Luksemburgut për përkrahjen e vazhdueshme në sektorin e shëndetësisë.

Ai ka theksuar se qeveria përmes komisionit të granteve ka ndarë në total në grantin për shëndetësi në komuna rreth 72 milionë euro, nga i cili grant do të përfitojë edhe komuna e Prishtinës. “Mirëqenia dhe shëndeti i qytetarëve është fokusi ynë kryesor, është qëllimi që na bashkon të gjithëve dhe si qeveri jemi të hapur për çfarëdo lloj ndihme në të ardhmen që e përmirëson jetën e qytetarëve. Sot të gjithë bashkërisht duhet të funksionojmë si një trup i vetëm

për ta çuar shëndetësinë në një nivel tjetër. Asnjë ndasi e çfarëdo natyre nuk është më e rëndësishme sesa shëndeti publik që mbetet qëllimi ynë i përbashkët”, ka thënë Vitia.

Sipas tij, sado e rënduar që të jetë gjendja në shëndetësi, energjitë tona duhet të jenë të koncentruara që shërbimet t'i avancojmë në një nivel tjetër. Për këtë arsye, ministria Vitia tha se Ministria e Shëndetësisë në kuadër të planit strategjik brenda këtij viti parasheh 41 milionë e 67 mijë euro për avancimin e infrastrukturës në shërbimet spitalore dhe klinike shëndetësore si një prej prioriteteve kryesore dhe të realizimit të vizionit të

qeverisë për shëndetësinë.

Të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua edhe kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, i cili falënderoi të gjithë kontribuuesit duke thënë se ky program është shumë i rëndësishëm për kujdesin parësor, veçanërisht për foshnjat dhe gratë shtatzëna. Ai ka falënderuar edhe infermierët që janë bartësit kryesorë të këtij projekti.

Në një fjalë rasti të pranishmëve iu drejtuan edhe shefja e zyrës së UNICEF-it për Kosovë, Nona Zicherman dhe ambasadori i Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz. Luksemburgu dhe UNICEF-i mbeten donatorët kyç të shëndetësisë në Kosovë.



OVLUÇK-ja i bën kërkesë policisë: Na mbroni objektin

PRISHTINË, 25 JANAR - Organizata e Veteranëve e Luftës e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka kërkuar nga policia që ta ruajë objektin e kësaj organizate për shkak të vjedhjes në Paris të një laptopi të një gjyqtari të Gjykatës Speciale me të dhëna sensitive. Kjo kërkesë e OVLUÇK-së, që është publikuar nga ushtruesi i detyrës së kryetarit të kësaj organizate, Faton Klinaku, ndërlihet me ngjarjet që kishin ndodhur më herët, ku persona të maskuar kishin dorëzuar dosje të Speciales në selinë qendrore të veteranëve të UÇK-së në Prishtinë.

Për shkak të këtyre dosjeve janë dënuar nga Specialja dy drejtuesit kryesorë të OVLUÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. Klinaku ka bërë me dije se i është drejtuar me këtë kërkesë drejtorit

të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, por ende nuk kanë marrë asnjë përgjigje. “Meqenëse kanë kaluar 24 orë nga kërkesa jonë drejtuar Policisë, e ende nuk na ka ftuar askush, si dhe nuk i janë përgjigjur kërkesës për t'i marrë masat, po e publikojmë: Z. Fehmi Hoti, ushtrues detyre i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës. I nderuar, siç jeni të informuar, në objektin e Organizatave të Dala nga Lufta e UÇK-së, në rrugën e UÇK-së në Prishtinë, ka pasur zhvillime rreth dosjeve të Gjykatës Speciale me seli në Hagë, thënë më konkretisht, një person i maskuar për tri herë me radhë i ka sjellë ato dosje në Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, gjë që për këtë, për më shumë se dy vjet, në mënyrë të pafajshme



po mbahen në paraburgim krerët e organizatës sonë. Po ashtu, siç është paraqitur në mediet tona e që e ka publikuar një gazetë franceze, ka pasur grabitje në

Paris dhe i është vjedhur laptopi një gjyqtari të Speciales me të dhëna sensitive, prandaj kërkojmë nga Ju që t'i merrni masat e duhura për ta ruajtur

objektin apo hyrjen e ndërtesës sonë, me qëllim që të mos përsëriten ngjarjet e shtatorit të vitit 2020”, ka shkruar Klinaku në “Facebook”.

Rreziku nga kafshët e ngordhura gjatë përmbytjeve



PRISHTINË, 24 JANAR - Fabrika për asgjësimin dhe riciklimin e kafshëve të ngordhura në Kosovë nuk funksionon dhe rreziku për përhapjen e ndonjë sëmundjeje të mundshme është potencial, thonë nga Oda e Veterinerëve të Kosovës. Mijëra shpezë dhe kafshë raportohet të kenë ngordhur ditët e fundit si pasojë e përmbytjeve që kanë përfshirë disa zona të Kosovës.

Vetëm në një fermë në komunën e Skenderajt, nga 19 janari, kanë ngordhur mbi 12 000 pula.

Pronari i saj, Liridon Geci, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se ato do të groposen më 25 janar. Sipas tij, groposja më herët e tyre ka qenë e pamundur për shkak të nivelit të lartë të ujit dhe baltës brenda në fermë.

Geci thotë se nxjerra e tyre nga ferma dhe më pas groposja do të bëhen në bashkëpunim me zyrtarët komunalë të cilët kanë caktuar një "lokacion të përshtatshëm" për groposje.

Valon Haliti, udhëheqës i Drejtorisë së Inspektoratit Komunal në Skenderaj, konfirmon për REL-in se

komuna ka vendosur që groposja e këtyre pulave të bëhet në fshatin Kotor.

Kotori gjendet në magjistralen Pejë - Mitrovicë, rreth tetë kilometra në veriperëndim të Skenderajt. "Ky fshat është kodrinor-malor dhe nuk ka afër vendbanime dhe puse të ujit", shpjegon Haliti.

Përveç Skenderajt, zona të tjera të goditura rëndë nga vërshimet kanë qenë Mitrovica e Veriut, Istogu dhe Klina.

Me gjithë interesimin e REL-it për numrin e shpezëve dhe kafshëve të ngordhura në këto komuna, zyrtarët e tyre nuk u përgjigjën.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Kosovës njoftoi se gjatë vërshimeve të 19-20 janarit kishte dëme të mëdha, mes të cilave edhe shpezë e kafshë të ngordhura, por nuk dha ndonjë shifër të saktë.

REL pyeti Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për humbjet në shpezë dhe kafshë, por nuk mori përgjigje. Në deklaratën e kësaj ministrie thuhet vetëm se komunat vendosin për lokacionin e

groposjes së këtyre mbetjeve. "Përderisa fabrika për asgjësimin dhe riciklimin e kafshëve të ngordhura dhe mbetjeve shtazore nuk është në funksion, komunat respektive i caktojnë lokacionet për groposjen e kafshëve [të ngordhura]", thuhet në deklaratë.

Aty, po ashtu, theksohet rëndësia e asgjësimin të shpezëve dhe kafshëve të ngordhura nën mbikëqyrjen e inspektorëve veterinarë, në mënyrë që, siç thuhet, të garantohet një asgjësim i sigurt për mbrojtje të shëndetit veterinar dhe atij publik.

Udhëheqësi i Odës së Veterinerëve të Kosovës, Xhevdet Krasniqi, thotë se autoritetet kompetente duhet t'i trajtojnë në mënyrë të sigurt mbetjet shtazore sepse, në të kundërtën, ka rrezik potencial për përhapjen e sëmundjeve të njerëzimit dhe kafshët. "Pas vërshimeve të fundit, rreziku është i madh për përhapjen e ndonjë sëmundjeje. Kosova duhet të ketë fabrikë për asgjësimin e mbetjeve shtazore", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Fabrikë ka, por jofunksionale

Në Drenas është ndërtuar impianti për trajtimin e mbetjeve shtazore qysh në vitin 2019, por ai nuk është në funksion. Në një raport të Zyrës Kombëtare të Auditimit, të publikuar në vitin 2021, është thënë se impiantit i mungojnë ende disa pajisje, përfshirë: gjeneratorin elektrik dhe tankun për deponimin e gazit natyror.

Ky projekt është realizuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës (AUV) në bashkëfinansim me Zyrën e Komisionit Evropian dhe ka arritur vlerën e 7.7 milionë eurove. Sekur do të vihesh në funksion, nuk është e qartë.

Si duhet të trajtohen mbetjet shtazore?

Operimi i kësaj fabrike është i domosdoshëm jo vetëm në rastet e fatkeqësive natyrore kur mund të ngordhin kafshë, por edhe në përditshmëri, thotë Skender Muji, ligjërues i Lëndës Higjiena dhe Mirëqenia e Kafshëve në

Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës.

Në mungesë të kësaj fabrike ai thotë se mbetjet shtazore duhet të groposen në lokacione të përshtatshme, që nuk ndikojnë në ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit. "Mënyra më ekologjike është groposja e tyre. Ne i quajmë gropa/varreza, të cilat hapen në një thellësi deri në tri metra në vise të larta gurorë, e ku ujërat nëntokësore janë shumë larg... Të gjitha kufomat në këtë gropë duhet të mbulohen me sasi të mëdha të dheut në mënyrë që të mos ketë mundësi t'i nxjerrin qentë ose mishngrënësit e tjerë", shpjegon Muji për "Radion Evropa e Lirë".

Megjithatë, trajtimi dhe menaxhimi i mbeturinave mbetet sfidë në përgjithësi, pasi në shumë komuna të Kosovës nuk ka kategorizim dhe klasifikim të tyre. "Në mungesë të ndarjes së veçantë, mbetjet shtazore hidhen bashkë me të tjerat, pa u kategorizuar sipas rrezikut që mund të paraqesin në kontaminimin e tokës dhe ujit", është thënë në raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të vitit 2021.

Abdixhiku takon qytetarët në kryeqytet: Kostoja e jetesës është bërë e papërbalueshme

PRISHTINË, 25 JANAR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka vizituar të mërkurën njërin nga tregjet e pemëve, perimeve e produkteve bazë në kryeqytet. Ai ka takuar qytetarë të shumtë të cilët kanë theksuar se "kostoja e jetesës është bërë e papërbalueshme". "Me këtë pushtet mijëra njerëz po përpiqen fort t'i bëjnë ballë rritjes së paprecedentë të

çmimeve. Përgjatë dy vjetëve të shkuara norma mesatare e inflacionit në Kosovë ka arritur në mbi 20 për qind, përderisa çmimet e produkteve bazë janë rritur për mbi 50 për qind. Kaq shumë ndryshim në kaq pak kohë nuk ka pasur asnjëherë. Pavarësisht prej kësaj rritjeje, qeveria nuk ka ofruar asnjë zgjidhje dhe jetën e dinjitetshme që familjet kosovare e meritojnë", ka thënë Abdixhiku.

Ai ka bërë me dije se propozimet e LDK-së janë refuzuar deri më tani jo sepse nuk ishin adekuate, por sepse ishin të LDK-së. "Nuk mund të vazhdojmë kështu. Duhet të heqim TVSh-në në produktet bazike, të ulim çdo barrë tatimore tani dhe t'i rrisim pagat në përputhje me inflacionin. Ky është plani i LDK-së, një plan në anën e familjeve dhe njerëzve punëtorë", ka deklaruar Abdixhiku.



Thesari qëmoti i dashur për myslimanët po konsiderohet si fyes, por nga kush?



Nga: Kenan Malik
The GUARDIAN
Përkthimi: Agron SHALA

Është një pikturë e bukur që u zbulua në një dorëshkrim persian të shekullit XVI, Përmbledhja e kronikave, që është një histori e Islamit. Aty tregohet Profeti Muhamed duke i marrë shpalljet e para kuranore prej engjëllit Gabriel [Xhebrail]. Christine Gruber, profesoreshë e artit islam në Universitetin e Miçiganit, e përshkruan atë si “kryevepër e pikturës së dorëshkrimeve persiane”.

Tetorin e kaluar, një ligjëruese e Universitetit Hamlajn në Minesotë, e shfaqti pikturën gjatë një mësimi onlajn për artin islam. Ligjëruesja (emri i së cilës nuk është treguar) kishte paralajmëruar se çfarë do të bënte në rast se dikush e sheh imazhin si fyes apo nëse nuk do fare që ta shohë atë. Sidoqoftë, një student u ankua tek autoritetet e universitetit.

David Everett, zëvendës-president i ekselencës gjithëpërfshirëse [organ që ndihmon universitetet për të zbatuar diversitetin dhe barazinë e pakicave] në Hamlajn, e dënoi ligjëratën si “patjetër të pavëmendshme, mosrespektuese dhe islamofobike”. Një letër e shkruar nga Mark Berkson – kryetar i departamentit të fesë – që mbronte ligjëruesen duke ofruar kontekst historik dhe fetar për veprimet e saj, u botua në faqen e internetit të gazetës studentore të universitetit, The Oracle, dhe më pas u hoq sepse “shkaktoi dëm”. Ligjëruesja u “lirua” nga detyrat e mëtejshme të mësimdhënies.

Është ky një rrefim dëshpërues, por shumë i njohur. Që nga Vargjet

Satanike e deri te karikaturat daneze dhe pastaj Charlie Hebdo, dekadat e fundit kanë shkaktuar një sërë polemikash, shpeshherë vrasare, për përshkrimet e Islamit që vlerësohen si blasfemi ose si raciste.

Megjithatë, ajo që bie në sy me incidentin në Hamlajn, është se imazhi që është në qendër të këtyre rreshtave nuk mund të përshkruhet si islamofobik – madje as në përkufizimet më të papërshtatshme. Është thesar artistik që lartëson Islamit dhe që prej kohësh është ruajtur nga myslimanët.

Megjithatë, që ti ta shfaqësh atë kjo tashti po dënohet si islamofobike sepse ... kështu thotë një student. Edhe nëse e vë në dyshim këtë pretendim, kjo do të thotë se ti shkakton “dëm”. Siç ka pyetur Berkson në një letër tjetër (të pabotuar) që e dërgoi në The Oracle – pasi e para ishte hequr: “A doni të thoni se mospajtimi me një argument është një formë ‘dëmtimi’?”

Kjo është pikërisht ajo që thotë universiteti. “Respekti për studentët e vëmendshëm myslimanë në atë orë mësimi do të duhej ta zinte vendin e lirisë akademike”, ka shkruar Fayneese Miller – presidente e universitetit – dhe Everett në një letër drejtuar stafit dhe studentëve. Në çfarë mënyre shfaqja e pikturës “nuk i respektonte” myslimanët? Ata që nuk donin ta shihnin, nuk kishin pse ta shikojnë. Por, të tjerët, përfshirë këtu myslimanët që dëshironin ta shihnin atë imazh, kishin të drejtë të angazhoheshin në një diskutim të historisë islame. Universitetet duhet ta mbrojnë të drejtën e të gjithë studentëve për ta praktikuar besimin që kanë. Ata

nuk duhet të lejojnë që ai besim ta diktojë kurrikulën. Kjo do të thotë ta futësh tabunë e blasfemisë nëpër orët e mësimi.

Hamlajni në mënyrë efektive dhe përtej fushëveprimit shkencor i ka mohuar fushat e tëra të historisë islame, sepse ato mund të shkaktojnë fyerje. Dhe, jo vetëm të historinë islame. Siç vërejtë Audrey Truschke, profesoreshë e asociuar e historisë së Azisë Jugore në Universitetin Raçgers, veprimi i Hamlajnit “treqikon ... profesorët që tregojnë gjëra në klasë, që nga arti paramodern islam, te imazhet hindu me svastika dhe deri te Imersioni [Piss Christ, fotografi e Andres Serranos e vitit 1987]”.

Dikush mund të thotë se burokratët e universitetit që i shpallën si të ndaluara nga Islami paraqitjet e Muhamedit – nëse kjo ishte e vërtetë – nuk e pyetën veten se pse në radhë të parë kishte piktura figurative islame për t’u shfaqur në një orë mësimi? Ka zhvilluar amnezi historike për shumë tradita islame, veçanërisht atë persiane, turke dhe indiane, të cilat kanë shfaqur portretizimet e Muhamedit; portretizime që gjenden në dorëshkrime, piktura, kartolina, madje edhe nëpër xhami.

Përderisa gjithmonë ka pasur debate për çështjet përbrenda Islamit, ndalimi i repte i paraqitjes së Muhamedit është kryesisht sunit dhe relativisht i kohëve të fundit. Rritja e vahabizmit – si një nismë fundamentaliste e Islamit që u zhvillua në shekullin XVIII dhe që përfundimisht u bë çimento ideologjike e Arabisë moderne Saudite – në veçanti ka qenë e rëndësishme. Petrodollarët sauditë kanë lejuar që karakteri fanatik i ashpër i vahabizmit të sigurojë

shkëmbime më të madhe globale. Megjithatë, siç vëren Gruber, në fund të vitit 2000 një studiu i lartë ligjor me bazë në Arabinë Saudite ka pranuar disa portretizime të Muhamedit si “të lejueshme dhe të lavdërueshme”. Vetëm pas 11 shtatorit dhe pas shfaqjes së formave më fundamentaliste të Islamit, ndalimi absolut i imazheve të Muhamedit u pranua më gjerësisht.

Veprimet e Universitetit Hamlajn janë kërcënim jo vetëm për lirinë akademike, por edhe për lirinë fetare. Ata në mënyrë implicite mohojnë shumëllojshmërinë e traditave që përbëjnë Islamit dhe ato tradita në një aspekt i dënojnë si aq fanatike sa që nuk mund të shfaqen në një orë të historisë së artit islam. Burokratët universitarë, njëjtë si jomuslimanët, marrin pjesë në një debat teologjik brenda Islamit dhe ata po e mbajnë anën e ekstremistëve.

Kjo është arsyeja se pse si myslimane, siç shprehet historiania Amna Khalid, është më e fyer nga veprimet e Hamlajnit që kanë “rrafshuar historinë e pasur dhe diversitetin e mendimit islam” dhe “ka privilegjuar një këndvështrim mysliman që është më ekstrem dhe më konservator”. Në një epokë në të cilën ka kërkesa që plani mësimor të “dekolonizohet”, shton ajo, “pozicioni i Hamlajnit është një lloj mbështetjeje e imperializmit, duke përforcuar një imazh monolit të myslimanëve që është propozuar nga kulti i Islamit autentik”.

Ndoshta aspekti më i dëmshëm i veprimit të Hamlajnit është përdorimi i gjuhës së diversitetit për t’ia hequr kuptimin vetë diversitetit. Kjo është një çështje që nuk kufizohet vetëm në Hamlajn.

Shumë njerëz sot kërkojnë që ne ta respektojmë diversitetin e shoqërisë, por ata nuk arrijnë ta shohin diversitetin e komuniteteve pakicë në ato shoqëri. Si rezultat, zërat progresivë shpeshherë hidhen poshtë si joautentikë, ndërsa figurat më konservatore çmohen si mishërimi i vërtetë i komuniteteve të tyre.

Kështu, “antiracizmi” liberal takohet me fanatizmin e djathtë antimusliman. Për fanatikët, të gjithë myslimanët janë reaksionarë dhe vlerat e tyre janë të papajtueshme me ato të shoqërive liberale. Për shumë liberale, të kundërshtosh fanatizmin do të thotë të pranosh idenë reaksionare si autentike myslimane; se të jesh mysliman do të thotë t’i shohësh karikaturat daneze si fyese dhe përshkrimin e Muhamedit si “të dëmshëm”. Edhe fanatikët edhe liberalët e fshijnë pasurinë dhe shumëllojshmërinë e komuniteteve myslimane.

Polemika e Hamlajnit tregon se si janë përmbysur konceptet e diversitetit dhe të tolerancës. Diversiteti dikur nënkuptonte krijimin e një hapësire për mospajtim, për mosmarrëveshje dhe për tolerancë, gatishmërinë për të jetuar me gjërat që mund të duken fyese ose të pakëndshme. Tashti diversiteti shumë shpesh e përshkruan një hapësirë në të cilën mospajtimit dhe mosmarrëveshjet duhet të fshihen në emër të “respektit”, ndërsa toleranca kërkon që njeriu të përmbahet nga fjalët ose t’i bëjë gjërat që mund të konsiderohen si fyese. Është koha për ne që ta rikuptojmë diversitetin dhe tolerancën në kuptimin e tyre original. /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Lirika Deva dhe Enxhi Sefaj nuk arritën ta mbyllnin shtegun në Itali

PRISHTINË, 25 JANAR - Skitaret e Kosovës, Lirika Deva dhe Enxhi Sefaj, kanë përfunduar garimin të mërkurën në

disiplinën e sllallomit në EYOF Friuli Venezia Giulia 2023. Të dy garueset ishin të pafat, pasi shkaku i kushteve

të vështira dolën nga shtegu në lëshimin e parë, sikurse edhe 23 garuese të tjera, pa llogaritur edhe lëshimin e

dytë. Lirika dhe Enxhi do të garojnë edhe sot (e enjte) në disiplinën e sllallomit të madh.



FC Prishtina nuk do ta votojë draft-statutin e FFK-së

PRISHTINË, 25 JANAR - FC Prishtina ka njoftuar se nuk do ta votojë draft-statutin e propozuar nga Federata e Futbollit e Kosovës. Klubi kryeqytetas me anë të një komunikate për medie ka bërë me dije se ka arsye të shumta për mos ta votuar këtë draft-statut.

Skuadra "bardhekaltër" konsideron se procesi i përgatitjes dhe draftimit është karakterizuar me parregullsi, mungesë transparence, si dhe mungesë të konsultimeve me klube. "Mangësitë e shumta dhe futja e neneve në këtë draft-statut, kryekëput për të mbajtur në funksion zyrtarët aktual të FFK-së duke përfunduar mundësinë e çfarëdo ndryshimi në struktura udhëheqëse të FFK-së për afate tejet të gjata. Pjesa më e madhe e komenteve janë shpërndarë nga klubet tjera dhe nuk dëshirojmë t'i përsërisim. I gjithë procesi i përgatitjes dhe draftimit është karakterizuar me parregullsi, mungesë transparence, si dhe mungesë të konsultimeve me klube. Ne fakt, është krejt e paqartë kush e ka draftuar këtë statut dhe kush e ka caktuar 'grupin e punës', i cili e ka përgatitur këtë draft duke mos konsultuar për asnjë moment përfaqësuesit e klubeve e në këtë rast edhe FC Prishtinën", thuhet në njoftimin e FC Prishtina.

Skuadra e Prishtinës e ka akuzuar FFK-në për moslicencim nga

Ministria e Sportit. Gjithnjë sipas klubit kryeqytetas, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, njëherë nga arsyet për moslicencim të FFK-së i përmend parregullsitë në organizimin e Kuvendit të kaluar të Federatës. "Në vend të përmirësimit të gabimeve të së kaluarës, FFK vazhdon të organizim të një Kuvendi tjetër, duke vazhduar me parregullsi sikurse në të kaluarën. Kjo na bën me dije se gjasat për tejkalim të situatës dhe licencimit të FFK nga ana MKRS janë minimale, për të mos thënë nuk ekzistojnë. Në fakt, FC Prishtina konsideron se ky statut është problemi më i vogël me të cilin është duke u ballafaquar futbollit kosovar aktualisht. Mos-licencimi i FFK-së ka sjellë si pasojë pamundësinë e realizimit të së drejtës për përfitim nga ligji për sponsorizim që është impakti me pozitiv në futbollin kosovar që nga ndërkombëtarizimi i futbollit tonë në UEFA dhe FIFA. Komitetit Ekzekutiv i FFK në vend të ndërmarrë hapa urgjent për të zgjidhur këtë situatë në mënyrë që të evitohet bankrotimi total të klubeve tona, merret me përpjekje për kontrabandim të një statuti, i cili në mendjen e tyre u siguron funksione të përjetshme, përfitime materiale të pafundme e shumë pak punë siç kanë bërë deri më tash", thuhet ndër të tjera në njoftimin e FC Prishtina.



"FC Prishtina asnjëherë nuk do të përliqë me votën e saj shkatërrimin që është duke u bërë këtij sektori nga ana FFK-së, e cila është federata e vetme në botë, e cila e fokuson energjinë në luftimin e klubeve të cilat i

përfaqëson. FC Prishtina nuk do të pajtohet asnjëherë që të tregtojë ardhmërinë e gjeneratave të fëmijëve tanë, për të mbajtur në funksion njerëz që vizionin e vetëm për zhvillim dhe përparim të futbollit e kanë zhvatjen dhe

përfitimin e parave në kurriz të perspektivës së fëmijëve dhe të rinjve kosovarë që e duan futbollin dhe duan të rriten në ambient të shëndetshëm, të rrethuar shpresa për sukses", thuhet në njoftimin e Prishtinës.

Jacobssoni, MPV e javës në Ligën Unike



PRISHTINË, 25 JANAR - Ndashjet e zhvilluara në mesjavë të Ligës Unike për femrat dhuruan ndeshje mjaft interesante. Flamurtari u rikthye te fitoret, duke mundur Penzën në udhëtim, kurse më e mira ishte amerikania Sophija Jacobsson me 27 pikë, 12 kërcime, tetë asistime, duke pasur indeksin e

ndeshjes 40, apo dukshëm më të lartë në këtë xhiro, duke u shpallur edhe MVP. Ajo u ndihmua nga Samra Omerbasiq me 27 pikë, shtatë kërcime dhe dy asistime. Përkundër se humbi Penza, Saranda Daci zhvilloi një ndeshje shumë të mirë me 30 pikë, 13 kërcime dhe katër asistime. Khadija Brown sërish u

dallua te Bashkimi në fitoren ndaj Prishtinës në kryeqytetin e Kosovës. Brown kishte 24 pikë e dhjetë kërcime. Në një superndeshje të zhvilluar mes Tiranës dhe Partizanit, vashat bardheblu triumfuan 69:67, ndërsa më e mira ishte Enisa Qosja me 31 pikë, tri kërcime dhe tri asistime.

Mallorca dhe Torino e kërkojnë Bardhin

Mallorca, 25 janar - Futbollisti shqiptar Enis Bardhi u bë pjesë e Trabzonsporit në fillim të këtij sezoni, por ai mund të largohet nga kjo skuadër shumë shpejt.

Interesim për lojtarin 27-vjeçar kanë shprehur një klub nga La Liga dhe një tjetër nga Seria A. Është skuadra ku aktivizohet Vedat Muriqi, Mallorca, ajo që

e dëshiron që në janar lojtarin shqiptar, i cili ka përvojë në kampionatin spanjoll ku më herët ka luajtur për Levantën. Ndërsa në Itali e dëshiron klubi

i Torinos, aty ku është pjesë një lojtar tjetër shqiptar, Mërgim Vojvoda. Klubi turk i Trabzonsporit kërkon 3 milionë euro për Bardhin.



Caktohen përzgjedhësit e Kosovës për grupmoshat e reja

PRISHTINË, 25 JANAR - Federata e Basketbollit e Kosovës njofton se janë përzgjedhur përzgjedhësit e Kosovës për grupmosha të reja. Përzgjedhës i Kosovës U20 te meshkujt do të vazhdojë të jetë Dritëro Sefaja,

me ndihmësin Dion Pllana. Përzgjedhëse e Kosovës U20 te femrat do të jetë ish-basketbollistja Shemsije Stublla, me ndihmësin Qëndrim Demi. Përzgjedhës i Kosovës te U18 në konkurrencën e meshkujve do

të jetë Brahim Veseli, me ndihmësit Endrit Elshani dhe Safet Kastrati. Përzgjedhës i Kosovës te U18 në konkurrencën e femrave do të jetë Furkan Saglik, kurse ndihmës do të jenë Emrah

Karatas dhe Aurora Muhaxheri. Ndërkohë, përzgjedhës i Kosovës U16 te meshkujt do të jetë Ibrahim Karabegu, ndërsa ndihmës të tij do të jenë Driton Obërtinca dhe Elbasar Gështhenja.



Përballje të zjarrta në 'Final Four'-in e Ligës së Kombeve

NYON, 25 JANAR - Është hedhur shorti për "Final Four" në Ligën e Kombeve në Nyon të Zvicrës, aty ku Italia, Kroacia, Holanda dhe Spanja kanë mësuar kundërshtarët. Fillimisht, "Furia e Kuqe" mësoi se do të përballtet me "azzurët", një takim që do të jetë spektakël i vërtetë, duke ditur se këta të fundit munguan në Kampionatin Botëror dhe do të synojnë fitimin e këtij trofeu. Në anën tjetër, "tulipanët" do të kenë punë me kroatët, një kundërshtar aspak i lehtë në letër dhe të dy padysim se do ta synojnë finalen. Spanja dhe Italia do të luajnë më 14 qershor, për të tentuar që të kalojnë në finale, derisa italianët do të synojnë të hakmerren ndaj spanjollëve për humbjen 2-1 në edicionin e kaluar. Në anën tjetër, gjysmëfinalja e dytë është ajo në mes të Kroacisë dhe Holandës me datë 15 qershor. Kujtojmë se ndeshjet finale të eventit do të zhvillohen në



Holandë nga data 14 qershor deri më 18 qershor teksa janë përcaktuar edhe dy qytetet mikpritëse, Rotterdam dhe Enschede. Është tashmë e përcaktuar që Holanda do ta

zhvillojë gjysmëfinalen e parë në Rotterdam në stadiumin me 51.117 vende të De Kuip, po ashtu siç është vendosur që po në Rotterdam të luhet edhe finalja e madhe.

Lakersat humbin derbin kalifornian, Denveri u rikthehet fitoreve

LOS ANXHELOS, 25 JANAR - Denver Nuggets rikthehet te fitorja në NBA pas triumfit në sekondat e fundit ndaj New Orleansit me rezultatin 99-98. Jokiçi realizoi sërish një "triple double", me 25 pikë 11 rebounde e 10 asistime, mbështetur edhe nga Murray po me 25 pikë. Nuggetsit shkëputet në krye në Konferencën e Perëndimit, duke lënë pas humbjen e fundit. Po në këtë konferencë, spektakël në derbi i Los Angeles, që fitohet nga Clippersat, teksa mundën me rezultat 133-115 Lakersat, në një



ndeshje që tregoi edhe njëherë problemet e këtyre të fundit. LeBron Jamesi ishte një "përbindësh" në fushë për skuadrën e tij, duke realizuar plot 46 pikë, por që nuk mjaftuan. Paul George me 27 pikë e Kawhi Leonard me 25 bënë diferencën në fushë për Clippersat. Në Lindje, tjetër humbje për Bostonin, e dyta

radhazi, që u mund 98-95 nga Miami Heat. Adebayo me 30 pikë e 15 rebounde më i miri për ekipin nga Florida, ndërsa 31 pikët e 14 reboundet e Tatumit për Celticsin mbetën për statistikë. Gjithsesi, Bostoni vijon ta mbajë kreun si skuadra me më shumë fitore gjatë këtij sezoni në NBA, ndërsa Miami ngjitet në vendin e gjashtë.

REZULTATET

Indiana - Chicago	116-110
Miami - Boston	98-95
New York - Cleveland	105-103
New Orleans - Denver	98-99
Dallas - Washington	126-127
Phoenix - Charlotte	128-97
Lakers - Clippers	115-133

Reali për Bellinghamin ofron 100 milionë euro dhe Camavingan

Ylli i Borussia Dortmundit, Jude Bellingham, rinovoi kontratën me klubin gjerman, por kjo nuk do të thotë se e ardhmja do të

jetë te verdhezinjtë. Interesim për mesfushorin anglez kanë shfaqur Manchester City dhe Real Madridi. Reali e ka gati

ofertën që do ta "lëkundë" Dortmundin. Sipas "Sky", "Los Blancos" është i gatshëm të ofrojë deri në 100 milionë euro

për 19-vjeçarin, por për të shtuar edhe më shumë shanset e nënshkrimit me Bellinghamin pritet t'i ofrojnë

Dortmundit edhe Eduardo Camavingan. Ky i fundit nuk e ka pasur besimin e plotë të Carlo Ancelottit.

SHKURT

Celina kalon te Stoke City

Reprezentuesi i Kosovës, Bersant Celina, i është bashkuar Stoke Cityt në formë huazimi. Celina, i cili sezonin e kaluar ishte lojtar i Ipswichit, tash është lojtar i Kasimpasas në huazim nga Dijoni, do t'i bashkohet Stoke City, pasi klubi ishte i gatshëm për të nënshkruar me të edhe në verë. Por, nënshkrimi i Celinës nuk u arrit për shkak të kontratës, që nënkuptonte se Ipswichi ishte i vetmi klub anglez që ai mund t'i bashkohej. Sezonin e kaluar Celina shënoi gjashtë gola në 35 paraqitje për Ipswich, duke përfshirë golin e sezonit të klubit, që ia shënoi Crewes në tetor të vitit 2021.

Al-Nassri e dëshiron edhe Modriqin

Al-Nassri nuk e ka ndër mend të ndalet, pasi Cristiano Ronaldo ishte vetëm hapi i parë pasi sheikët sauditë vijnë projektin e tyre për të qenë në qendër të opinionit sportiv. Sipas medieve vendase, Al-Nassri ka rezervuar shërbimet e Luka Modriqit. Mesfushori kroat, lideri absolut i Real Madridit, i ka thënë "Po" propozimit të Al-Nassrit. Modriqi pritet të transferohet në fund të këtij sezoni për ta formuar edhe një herë dyshen me Ronaldon.

Ibra: E çova futbollin francez në një nivel botëror

Veterani i Milanit, Zlatan Ibrahimović, foli për dashurinë e tij për Francën dhe reflektoi për kohën e kaluar te Paris Saint-Germaini. 41-vjeçari aktualisht është duke punuar në promovimin e filmit "Asterix and Obelix - The Middle Kingdom", në të cilin ai luan Caius Antivirus, krahun e djathtë të Julius Caesar. Duke folur për stacionin radiofonik France Inter, Ibrahimovići diskutoi fillimisht ambiciet e tij në botën e kinemasë, por sulmuesi suedez më pas reflektoi për kohën e tij në Ligën 1 me Paris Saint-Germainin. "Unë e dua Francën, kalova katër vjet në Francë dhe e çova futbollin francez në një nivel botëror. Kjo nuk është arrogancë, është besim në cilësitë e mia", ka thënë Ibra.

Tost: Mick Schumacherin e larguan nga Formula 1 për arsye politike

Shefi i skuadrës Alpha Tauri, Franz Tost, një nga personat që ka punuar më së shumti me të rinjtë, ka rrëfyer për mediet italiane se arsyeja pse Mick Schumacher u largua nga Formula 1 këtë sezon ka prapaskenë politike. "Mick mund të vinte te skuadra jonë dhe do të më pëlqente shumë të ishte pjesë e ekipit tonë. Jam i bindur që ka talent dhe i ka të gjitha letrat në rregull për të garuar me sukses në Formula 1. Ne nuk bëmë një ofertë pasi në mes hynë rrethana të tjera, le të themi arsye politike, duke qenë se ishte një pilot që vinte nga Akademia Ferrari", u shpreh Tost, shefi i Alpha Tauri. "Nuk patëm një angazhim mes nesh dhe Mick, por kam një opinion të mirë për të si pilot. Unë jam i idesë se një pilot i ri ka nevojë të garojë 3 sezone në Formula 1 për t'i fituar të gjitha kompetencat e nevojshme. Vetë, pas tre sezonesh, mund të thuash se çfarë ai mund të bëjë e çfarë jo, mund të qëndrojë në F1 apo jo", ka shtuar Tost. Mick Schumacher këtë vit do të jetë piloti rezervë te Mercedesi. "Mercedesi është një skuadër e madhe, një nga më të mirat në Formula 1 dhe Mick mund të mësojë shumë gjëra duke qenë pranë tyre", ka deklaruar Franz Tost.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues